



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:036415

Datë: 26.10.2023

Numri i dokumentit: 04834772

C – IV. – 14 - 0862

Paditësja :

Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës SH.A, me seli në Prishtinë.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 , Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.26.10.2023**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. PRANOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Prishtinë, **NDRYSHOHET**, Vendimi i Autoriteti i Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), PRN102-0012 i dt.07.02.2014 për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), ”Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë (në likuidim), si dhe **OBLIGOHET**, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditëses, t’ia kompensoj për fatura të pa paguara për periudhën prej Dhjetor 2006 deri në Janar 2008 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), ”Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë (në likuidim), shumë prej **3,383.00 € (tre mijë e tetë qind e tri dhjetë e tetë euro)**, dhe atë me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 13 shkurt 2014, paditësja, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) me seli në Prishtinë përmes postës parashtrori ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN102-0012 dt.07.02.2014, e me të cilin Vendim kërkesa e ankueses për kompensim për faturat e pa paguara për periudhën dhjetor 2006 – janar 2008, në shumë e pretenduar në prej 3,830.00 €, në emër të

borxhit për NSH “Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë (në likuidim), i është refuzuar si e pavlefshme. Ankuesja – paditësjja, nuk pajtohet me Vendimin e AL-së, duke theksuar për shkak të shkëlqeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, r me propozim që të aprovohet ankesa, të ndryshohet vendimi i kontestuar dhe të aprovohet kërkesa lidhur me detyrimin e NSH, “Tregtia e Kosovës” për pagesën e shumës 3,830.00 €. Më tej paditësi thekson se në procedurë të likuidimi me ka parashtruar kërkesën për borxh duke i bashkangjitur provë materiale faturat dhe kartelën e blerësit dhe historinë e llogarisë, por AL me Vendimin, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, ka refuzuar kërkesën në konstatimin se kërkesa është parashkruar sipas nenit 387 të LMD (1978), duke konsidruar se në rastin konkret duhet zbatuar dispozitat nga neni 374 të LMD ku citon se :“kërkesa reciproke të personave shoqërorë juridik nga kontrat për qarkullimin e mallërave dhe shërbimeve si dhe të kompensimeve të bëra lidhur me kontrata parashkruhen për tre vjetë”, dhe rezulton se Komisioni për likuidim si rezultat i shkëlqeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës material, konsideron të pabazuar kërkesën e kreditorit.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si “ankesë”, mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi kësaj ankese – padie, nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë.

Me Urdhrin e saj, C – IV. -14 –0862 të dt.31.03.2023, kjo gjykate, e ka urdhëruar paditësen, që ti përgjigjet gjykatës sipas përbajtjes në urdhër, për të cilën paditësi me dt.14.08.2023, i është përgjigjur gjykatës sipas urdhrin, si dhe duke përsëritur thëniet e parashtruar në ankesë, si dhe duke përsëritur procedurën gjyqësore përmbarimore të lëndës E.nr.172/08 të ish Gjykatës Ekonomike në Prishtinë dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë me kërkesë kryesore të njëjtë, ndaj të paditurës NSH “Tregtia e Kosovës” dhe se kësaj parashtrese, ia ka bashkangjitur në kopje: Vendimin e AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, shkresat e lëndës, E.nr.172/08, në përbërje të saj me faturat gjegjëse për vitet 2006 – 2008 me numrat telefonik të ndryshuar, Aktvendimin, E.nr.172/08 të dt.16.09.2009 të ish Gjykatës Ekonomike në Prishtinë, ankesën e dt.23.09.2009, Konkulzion, Cp.nr.1908/16 të dt.10.11.2009, aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.113/17 të dt.30.10.2017, dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac.nr.2852/2016 të dt.25.07.2017 për lëndën e përmbaruesit privat.

Me dt.22.08.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë, ka parashtruar mbrojtje ndaj ankesës së paditësit të parashtruar kundër Vendimit, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, të AL-së, se i përmbahet qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit, ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe zbatim të saktë të dispozitave ligjore, se parashtruesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që e ka shkelur Autoriteti i Likuidimit, andaj vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit nr.04/L - 034, dhe se nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin, dhe se ankesa është e pavlefshme. E paditura më tej citon se ankesa është e pabazuar në pajtim me nenin 36.2.1 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP, se AL ka kryer vlerësimin e kërkesës dhe ka gjetur atë të pavlefshëm ku parashikon se “*elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*”, dhe nenit 378 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), që parashikon se “*kërkesat për shpenzime postare dhe telefonike parashkruhen për një vit*”, dhe në vartësi me

dispozitat e mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur para gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent brenda një viti nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë kryer kundrejt parashtruesit obligimet e saj që rrjedhin nga marrëdhënia tregtare dhe i paraqet gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe ta vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, si provë ka bashkangjitur kopje Vendimin e AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014.

Me Urdhrin e kësaj gjykate dt.06.09.2023, paditëses, i është dërguar mbrojtja (përgjigja) e të paditurës, të cilën paditësi e ka pranuar dt. 11.09.2023, por nuk i është përgjigjur gjykatës.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme DhPGJSK), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji .

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëses, duhet pranuar në tërësi si e bazuar dhe Vendimi i kontestuar i AL-së, PRN102-0012 i dt.07.02.2014, duhet të ndryshohet.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditëses.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar NSH “Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.07.07.2014, ndërsa paditësi kërkesën e ka paraqitur me dt.27.08.2014, tek AL-ja për pagesën e borxhit për faturat e pa paguara të shërbimeve telefonike dhe të internetit për periudhën dhjetor 2006 – janar 2008, në shumën e pretenduar prej 3,830.00 €, dhe se e AL-ja me Vendimin e tij, PRN102-0012 dt.07.02.2014, kërkesën e ankuesit, e ka refuzuar si të pa vlefshme e kundër të cilit Vendim, ankuesja - paditësja pranë DhGJSK-së, ka parashtruar ankesë me dt.13.02.2014, pra brenda afatit ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014 dhe se kësaj ankese/padie, ia ka bashkangjitur, Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014.

Gjykata, pra vlerëson se padia/ankesa e paditëses i plotëson kriteret e afatshmërisë dhe pranueshmërisë në bazë të nenit 36 lidhur me nenin 33 dhe 35 të Ligjit, Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) dhe nenit 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në për paraqitjen e një ankesës pranë DhPGJSK-së.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se nuk është kontestuese se e paditura, NSh “Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë, e të cilën e menaxhon AKP-ja, ka shfrytëzuar shërbimet telefonike për periudhën dhjetor 2006 – janar 2008, të ofruara nga paditësja, për të cilën paditësi pretendon shumë prej 3,830.00 € por kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbetet afati i parashtrimit të kërkesës tek e paditura për realizimin e shumës së pretenduar, për të cilën e paditura, e ka refuzuar me Vendimin e saj, PRN102-0012 të dt.07.02.2014 dhe atë mbi bazën e dispozitave nga neni 36.2.1 dhe 2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP ku citon se *“elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme për refuzimin e kërkesës apo të interesit të pretenduar të kapitalit..... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshme nga kufizimet kohore të aplikueshme”* lidhur me nenin 378 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), që parashikon se *“kërkesat për shpenzime postare dhe telefonike parashkruhen për një vitë”*, e të cilën qëndrim të të paditurës e kundërshton, paditësja duke aluduar se në vartësi me dispozitat e mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur para gjykatës apo ndonjë autoriteti tjetër kompetent brenda një viti nga momenti kur NSh-ja pretendohet të mos ketë kryer pagesat e faturave për detyrimin gjegjës të kërkuar në të holla.

Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një kërkesë të pa siguruar pra për shfrytëzimin e shërbimit të telefonisë për periudhën dhjetor 2006 – janar 2008, të ofruara nga paditësja, për të paditurën, NSh-në fjalë të cilën e menaxhon, AKP-ja, dhe se për këtë natyrë të kërkesave, bëhet fjalë në nenin 40 par.1 pika 7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L- 034 për AKP-në, që flet për Prioritetet e kërkesave dhe interesave, aty parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha Kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë...”*.

Në këtë çështje juridike gjykata gjen se e paditura me rastin e vendosjes përmes Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, është bazuar në atë se kërkesa e paditëses është e pas afatshme sipas dispozitave të zbatueshme ligjore nga neni 36.2.1, i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP lidhur me nenin 378 të LMD (1976), pasi që kërkesat periodike mujore kanë rrjedh veç e veç të afateve, si dhe çdo kërkesë e veçantë mujore eventuale duhet të argumentohet me prova konkrete materiale, për të cilën pala paditëse, ka arritur të dëshmoj një fakt të tillë dhe se për kërkesat e veçanta gjegjësisht për periudhën Dhjetor 2006 - Janar 2008, sipas faturave të paraqitura në emër NSh “Tregtia e Kosovës” me seli në Prishtinë në likuidim, nuk e argumentojnë dispozitat nga neni 36.2.1 dhe 2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në lidhur me nenin 378 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), dhe pretendimet e parashtrueses, paditëses, i referohen periudhës kohore 2006 - 2008, sipas faturave, për të cilën me kalimin e afatit prej 3 viti gjegjësisht nga janari i vitit 2009, konstaton se janë të afatshme dhe të pa parashkruara siç pretendon, pala e paditur sepse paditësja, para bërjes së kërkesës në procedurën likuidimit, me dt.31.03.2008, pranë ish Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, kishte paraqitur propozimin për përmbarim të faturave të pa paguara për periudhën prej Dhjetor 2006 deri në Janar 2008 e në shumë prej 3,100.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSH), *“Tregtia e Kosovës”* me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe se me këtë veprim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit prej tre viteve të detyrimit në të holla - shërbimet telefonike për secilin vit kalendarik.

Në nenin 372 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 , që bënë fjalë për kërkesa periodike, aty thuhet se : *“Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) si kur është fjala për kërkesat periodike aksesore, sikundër është kërkesa e kamatës, ashtu edhe kur është fjala për kërkesën periodike të atilla ... parashkruhen tre vjet nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë”*.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesat për shërbimet telefonike e të cilat kanë natyrë periodike dhe këto kërkesa parashkruhen në afatin prej tre vjetëve nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë. Po ashtu dispozitë të ngjajshme ka edhe në nenin 353 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për kërkesat periodike e në të cilin, thuhet se : *''Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ''*.

Në nenin 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që flet për afatin një vjeçar të parashkrimit, parashihet se : *''... Kërkesat e postës, telegrafit e të telefonave për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afatet tremujore, apo më të shkurtëra ''* ndërsa dispozitë identike për këtë, kemi edhe në nenin 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), Nr. 04/L-077 të dt.10 maj 2012, që flet për afatin një vjeçar të parashkrimit, thuhet se : *'' ... kërkesat e postës dhe kompanive të telekomit për përdorimin e telefonit e të separateve postare, si dhe kërkesat e tjera të tyre që arkëtohen në afate tre (3) mujore apo më të shkurtra; Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti ... ''*.

Në nenin 360 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që flet për Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, aty, parashihet se : *''Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të përfillë parashkrimin në qoftë se debitori nuk e ka invokuar atë''*. Ndërsa në nenin 374 të LMD-së, GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që bënë fjalë për kërkesat reciproke nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve, aty parashihet se : *''Kërkesat reciproke të personave shoqëror juridikë nga kontrata në qarkullimin e mallrave e të shërbimeve si dhe kërkesat e kompensimit për shpenzimet e bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tre vjet. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo livrim malli, punë ose shërbim të kryer''*. Po ashtu edhe në nenin 341 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) të Republikës së Kosovës, Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012 e që flet për Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, aty, parashihet se: *''Me parashkrim shuhet e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi krijohet kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj, brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Gjykata nuk mund të merr parasysh parashkrimin, në qoftë se debitori nuk thirret në atë''* derisa në nenin 355 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Republikës së Kosovës, Nr. 04/ L-077 të dt.10 maj 2012 e që flet për Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale, aty thuhet se: *''Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer''*.

Lidhur me ndërprerjen e afatit të parashkrimit, bëhet fjalë në nenin 388 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-), GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 e që flet për ngritjen e padisë, e aty thuhet se : *''Parashkrimi ndërpritet me ngritjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose organit tjetër kompetent me qëllim përcaktimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës''* ndërsa në nenin 369 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), GZ e Republikës së Kosovës, Ligji, Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012, thuhet se : *''Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarr kundër debitorit para gjykatës ose autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës.''*

Gjykata duke i analizuar provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka konstatuar se kërkesat e postës, e në rastin konkret për faturat e pa paguara për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike, janë

kërkesa që kanë të bëjnë në mes 2 (dy) personave juridik dhe me natyrë tjetër juridike dhe ky shërbim nuk është për nevoja nevojat shtëpiake dhe se kjo natyrë e kërkesës në të holla, parashkruhet në afatin prej 3 (tre) viteve e jo në afatin prej 1 (një) vit siç e ka cekur e paditura, në arsyetimin e Vendimit të saj, PRN102-0012 të dt.07.02.2014 kur e ka refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e paditëses.

Gjykata ka shqyrtuar edhe arsyetimet e pretendimeve dhe provave tjera të paraqitura lidhur me lëndën, E.nr.172/08, sipas propozimit për përmbarim, por lidhur me këtë gjykata mbi bazën e bërjes së këtij propozimi për përmbarim, nga pala paditëse, e ndryshon çështjen e vendimmarrjes së AL-së të shprehur me Vendimin e tij, PRN102-0012 të dt.07.02.2014 edhe pse të njëjtat pretendime dhe prova nuk janë parashtruar para AL-së në procedurë të likuidimit, dhe në këtë kuptim, paditësja, ka arritur që të bind gjykatën se ka parashtruar prova në mbështetje të kërkesës së saj derisa vendimet tjera të procedurës gjyqësore, dhe të përmbaruesit privat e të bashkangjitura padisës së paditëses, edhe pse të bëjnë me raste tjera gjyqësore, propozimi për përmbarim i bërë nga paditësja me dt.31.03.2008, pranë ish Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, kishte paraqitur propozimin për përmbarim të faturave të pa paguara për periudhën prej Dhjetor 2006 deri në Janar 2008 e në shumën prej 3,100.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Tregtia e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), e me këtë veprim e ka ndërprerë afatin e parashkrimit dhe ka të bëjë pikrisht me kërkesën e paditëses, e cila me Vendimin e AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, i ishte refuzuar si e pa vlefshme. Andaj gjykata konstaton se mbi bazën e fakteve të paraqitura të paditëses tani para gjykatës, ato mund t'i marrë si të besueshme për pranimin e kërkesës së palës paditëse, në shqyrtimin e mëtejshëm të fakteve vendimtare lidhur me provat e prezantuara dhe sipas kësaj gjendje faktike, gjykata ka gjetur se me Vendimin, PRN102-0012 e dt.07.02.2014, AL-ja, nuk ka vepruar drejtë kur e ka bërë refuzimin e si të pavlefshme të kërkesës së paditëses e duke u thirr në afatin 1 (një) vjeçar të parashkrimit të kërkesës së saj pasi që kërkesa e palës paditëse, është kërkesë që parashkruhet në afatin prej 3 (tre) viteve sepse është kërkesë në të holla jo për nevoja shtëpiake (amvisërisë) por është kërkesë nga raporti në mes 2 (dy) personave juridik. Pra, në këtë kuptim, ankuesja – paditësja, para gjykatës ka arritur që të argumetoj pretendimin e saj dhe përmes provave të bashkangjitura ankesës – padisë së saj, dhe në mbështetje të kërkesës së tij, gjykata gjen se, pretendimet e ankueses - paditëses lidhur me të drejtën e saj në kompensimin në fjalë, janë të mbështetura në ligj dhe me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë pranuar si si të bazuara nga ana e kësaj gjykate.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, nuk është i bazuar dhe i drejtë qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e AL-së, PRN102-0012 të dt.07.02.2014, kur kërkesën e paditëses në emër të kompensimit për fatura të pa paguara, për periudhën e që pretendohet të mos jenë paguar, është i parashkruar duke e konsideruar si të pas afatshme dhe të parashkruar sipas nenit 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, lidhur me nenin 378 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) dhe se qëndrimi i AL-së në kërkesën e parashtruar duke vlerësuar si të pavlefshme të kërkesën, bazohet në nenin 378 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978), i cili parasheh afatin 1 vjeçar të parashkrimit, ky qëndrim i AL-së, është jo i drejtë sepse kërkesa në fjalë e paditëse është kërkesë e cila parashkruhet në afatin prej 3 vjetëve dhe se paditësja, edhe pse para AL-së në procedurën e likuidimit, disa nga provat nuk i kishte parashtruar por të njëjtat prova i ka paraqitur pranë kësaj gjykate e veçmas propozimin e bërë për përmbarim të dt.31.03.2008, pranë ish Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, dhe atë për përmbarimin e faturave të pa paguara për periudhën prej Dhjetor 2006 deri në Janar 2008 e në shumën prej 3,100.00 € nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Tregtia e Kosovës" me seli në Prishtinë (në

likuidim), me këtë veprim paditësja e ka ndërprerë afatin e parashkrimit dhe atë në kuptim të nenit 388 të LMD-së, GZ e RSFJ-së, Nr.29/1978 dhe nenit 369 të LMD-së, GZ e Republikës së Kosovës, Ligji, Nr.04/L-077 të dt.10 maj 2012. Andaj nisur nga kjo gjendje, gjykata vie në përfundim se paditësja, kishte ofruar shërbime për shfrytëzimin e shërbimeve telefonike për NSh-në në fjalë dhe se NSh-ja, i kishte mbetur borxh për faturat e pa paguara, për periudhën e lartcekur dhe kësaj, paditëses, i takon e drejta në kompensimin e tyre. Andaj gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore, kërkesëpadia e paditëses, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Prishtinë, duhet të pranohet si e bazuar kurse Vendimi, PRN102 - 0012 i dt.07.02.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Tregtia e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), duhet të ndryshohet si dhe duhet të obligohet, e paditura, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë - Autoriteti i Likuidimit (AL), që paditëses, t'ia kompensoj shumën prej 3,383.00 € në emër të faturave të pa paguara për periudhën prej Dhjetor 2006 deri në Janar 2008 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Tregtia e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), dhe atë me prioritetet sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të jap arsytetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale sepse edhe pse pala paditëse si palë e suksesshme në procedurë (pala e cila e ka fituar gjykimin), e njëjta, nuk i ka kërkuar shpenzimet gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2023:036415, 26.10.2023

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).